

VENDIM
Nr. 791, datë 24.12.2025

**PËR PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE E TË KRITEREVE PËR ZHVILLIMIN E
PROJEKTEVE ARKEOLOGJIKE NËNUJORE, SI DHE TË AKTIVITETEVE TË
TJERA, QË PREKIN DIREKT OSE INDIREKT TËRËSINË E VLERAVE
ARKEOLOGJIKE DHE HISTORIKE NËNUJORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 156, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim përcakton kushtet e kriteret për zhvillimin e projekteve arkeologjike nënujore dhe të aktiviteteve të tjera, që prekin direkt ose indirekt tërësinë e vlerave arkeologjike dhe historike nënujore.

2. Ky vendim zbatohet për:

a) projektet e zhvilluara nga institucione shtetërore ose nga operatorë privatë të autorizuar/licencuar, sipas legjislacionit në fuqi;

b) çdo aktivitet kërkimor-shkencor ose ndërtimor në ujërat e brendshme dhe në ujërat detare territoriale të Republikës së Shqipërisë;

c) çdo ndërhyrje që mund të prekë integritetin e artefakteve, anijeve të fundosura ose objekteve arkeologjike të tjera nënujore.

3. Projekte arkeologjike nënujore janë aktivitete që kanë trashëgiminë kulturore nënujore, si objekt kryesor, dhe, të cilat, drejtpërdrejt ose tërthorazi, mund ta dëmtojnë trashëgiminë kulturore nënujore.

4. Projektet arkeologjike nënujore mund të zhvillohen nga:

a) institucionet e specializuara dhe/ose në bashkëpunim me institucione të huaja, që kryejnë veprimtari të kërkimit arkeologjik, të cilat do të kryejnë projekte arkeologjike nënujore në territore të njohura ose jo si zona me vlera arkeologjike. Në rastet kur këto zona bien brenda territorit të zonave të mbrojtura, institucionet e specializuara, si dhe veprimtaritë e kërkimit arkeologjik respektojnë edhe kërkesat e legjislacionit në fuqi për zonat e mbrojtura;

b) subjekte të licencuara në fushën e arkeologjisë nënujore, sipas legjislacionit në fuqi për trashëgiminë kulturore.

5. Aktivitete të tjera, që prekin direkt ose indirekt rastësisht trashëgiminë kulturore nënujore, janë aktivitete, të cilat, pavarësisht se nuk e kanë trashëgiminë kulturore nënujore si objektin e tyre kryesor ose një nga objektet e tyre, mund ta dëmtojnë trashëgiminë kulturore nënujore. Gjatë kryerjes së këtyre aktiviteteve zbatohen parashikimet e legjislacionit në fuqi për zonat e mbrojtura.

6. Zhvillimi i projektit arkeologjik nënujor, i cili do të zhvillohet nga institucionet e specializuara ose subjektet e licencuara për veprimtari arkeologjike nënujore, mund të kryhet vetëm me lejen përkatëse nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale (KKTKM).

II. KUSHTET PËR ZHVILLIMIN E PROJEKTEVE ARKEOLOGJIKE NËNUJORE

Projektet arkeologjike nënujore zbatohen në përputhje me këto kushte:

1. Ruajtja në vendin e gjetjes, *in situ*, trajtohet si zgjidhja parësore. Nxjerrja e objekteve nga vendi i gjetjes nënujore lejohet vetëm në rastet kur ruajtja *in situ* nuk është e mundur dhe vetëm

për qëllime studimore, vlerësuese ose arsye të tjera, që lidhen me ruajtjen, mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë, pa asnjë synim fitimprurës.

2. Aktivitetet e drejtuara ndaj trashëgimisë kulturore nënujore duhet të përdorin teknika joshkatërruese dhe metodat e vrojtimit e jo të përfutimit të objekteve. Nëse është i nevojshëm gjurmimi ose përfutimi për qëllimin e studimeve kërkimore-shkencore ose për mbrojtjen përfundimtare të trashëgimisë kulturore nënujore, metodat dhe teknikat e përdorura duhet të jenë sa më pak shkatërruese, që të jetë e mundur dhe të kontribuojnë në ruajtjen e pjesëve të mbetura.

3. Trashëgimia kulturore nënujore nuk tregtohet, shitet, blihet ose këmbëhet si mall në treg.

4. Sigurojnë informimin e publikut dhe botimin/publikimin e rezultateve të projektit në revistat shkencore arkeologjike, brenda dhe jashtë vendit.

5. Respektojnë mjedisin ujor dhe ekosistemet përkatëse, në përputhje me parashikimet në legjislationin për mjedisin.

6. Ndalohet çdo veprim që dëmton mjedisin ujor, florën, faunën ose ndot cilësinë e ujit, në përputhje me parashikimet e legjislationit për mbrojtjen e mjedisit.

7. Zbatimi i projekteve duhet të sigurojë ruajtjen fizike të objekteve arkeologjike, që zbulohen gjatë zhvillimit të tij, duke krijuar kushte laboratorike të përshtatshme, si dhe transport të sigurt, nga momenti i zbulimit deri te depozitimi në laborator.

8. Zbulimet e papritura ose ndryshimet në rrethana kërkojnë rishikim të projektit pranë KKTKM-së.

III. KRITERET PËR ZHVILLIMIN E PROJEKTEVE ARKEOLOGJIKE NËNUJORE

1. Projekti arkeologjik i parashikuar në pikën 6, të kreut I, të këtij vendimi, kur paraqitet pranë KKTKM-së, duhet të përmbajë:

a) qëllimin dhe objektivat shkencorë, që përfshijnë identifikim, hulumtim, dokumentim, studim, restaurim dhe metodologji, sipas standardeve bashkëkohore, në respekt edhe të mjedisit ujor dhe të ekosistemeve;

b) planin metodologjik të punës dhe teknikat që do të zbatohen;

c) një vlerësim paraprak të ndikimit për mjedisin ujor nga aktivitetet e projektit;

ç) një vlerësim të studimeve të mëparshme ose paraprake, nëse aplikohet;

d) listën e personelit kërkimor-shkencor e teknik dhe kualifikimet;

dh) planin e sigurisë dhe emergjencave;

e) planin e konservimit dhe magazinimit të materialeve, në bashkëpunim të ngushtë me autoritetet kompetente;

ë) planin financiar dhe burimet e financimit;

f) afatin e pritshëm kohor për përfundimin e projektit;

g) planet për analizat pas punës në terren dhe aktivitetet e tjera;

gj) menaxhimin dhe mirëmbajtjen e vendit për të gjithë kohëzgjatjen e projektit;

h) program dokumentimin;

i) depozitim të gjetjeve, duke përfshirë trashëgiminë kulturore nënujore;

j) masat në lidhje me ambientin;

k) përgatitjen e raportit;

l) një program publikimi.

2. Projekti arkeologjik, i parashikuar në pikën 6, të kreut I, të këtij vendimi, kur paraqitet pranë KKTKM-së, duhet të përmbushë kriteret teknike dhe logjistike, si më poshtë vijon:

a) Të ketë një drejtues projekti;

b) Të ketë arkeologë, në përputhje me natyrën e projektit dhe staf teknik ndihmës të specializuar për zhytje nënujore, të cilët zotërojnë gradën e tretë të zhytësit ose superiore, të mbrojtur në një

nga shkollat didaktike të njohura, si: Shkolla Ndërkombëtare për Zhytje – SSI, Konfederata Botërore e Aktiviteteve Nënujore – CMAS, Shoqata Profesionale e Instruktorëve të Zhytjes – PADI ose të ngjashme;

c) Të ketë arkeologë, në përputhje me natyrën e projektit (arkeologë të licencuar në veprimtari të arkeologjisë nënujore dhe teknik ndihmës të specializuar për zhytje nënujore);

ç) Të ketë staf për përpunimin e gjetjeve;

d) Të ketë specialist konservues;

dh) Të ketë specialist qeramike, monedhash, metalesh, objektesh qelqi etj.;

e) Të ketë skicograf;

ë) Të ketë ekspertë, të cilët do të bëjnë të mundur realizimin e plotë të një projekti, nga fillimi deri në fazën e fundit të tij;

f) Të disponohen mjetet logjistike të specializuara për realizimin e zhytjes dhe infrastrukturën e domosdoshme, përfshirë mjetet lundruese, në pronësi ose me qira;

g) Në rastet e gërmimeve arkeologjike, të sigurojë kushte të përshtatshme për trajtimin dhe ruajtjen e përkohshme të objekteve arkeologjike, sipas standardeve të Këshillit Ndërkombëtar të Monumenteve dhe Siteve ICOMOS (1996/2001), të ndryshuar;

gj) Të disponojë dokumentin për sigurimin e jetës për drejtuesin dhe stafin shoqërues të projektit, në standardet e Agjencisë Ndërkombëtare për Sigurimin e Zhytësve *DAN EUROPE*.

IV. KRITERET DHE KUSHTET PËR ZHVILLIMIN E AKTIVITETEVE QË PREKIN VLERAT NËNUJORE

Institucionet e specializuara dhe subjektet e licencuara për veprimtari arkeologjike nënujore duhet:

a) të plotësojnë objektiva të qartë, si dhe kriteret që përfshijnë identifikim, hulumtim, dokumentim, studim, restaurim dhe metodologji, sipas standardeve bashkëkohore në respekt edhe të mjedisit ujor dhe ekosistemeve;

b) të respektojnë kriteret e parashikuara në pikën 2, të kreut III, të këtij vendimi.

V. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Ngarkohen ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku